

PLANIFIKIMI DHE ZBATIMI I PROGRAMIT
PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE
MASA 10: MBËSHTETJE FINANCIARE PËR
PROJEKTET DHE INICIATIVAT QË SYNOJNE
PËRMIRËSIMIN E POZITES SË GRUAS NË
SHOQERI DHE EKONOMI

Koncept Dokument



Agjencia për Barazi Gjinore
Zyra e Kryeministrit të Kosovës

I. Arsyetimi

Koncepti dokumenti “Sëbashku për rigjallërimin shoqëror dhe luftimin e pasojave të COVID-19”, i ndërmarrë në reflektim dhe kundërpërgjigje ndaj situatës së krijuar nga efektet e pandemisë COVID-19, është hartuar në frymën e vendimit të qeverisë të datës 13.08.2020, Nr.01/23, për Planin e Zbatimit të Programit për Rimëkëmbjen Ekonomike dhe në zbatim të drejtpërdrejtë. Kriza socio-ekonomike e shkaktuar nga COVID-19 në këtë periudhë gati 6-të mujore në Kosovë, na ka treguar se i afekton burrat dhe gratë në mënyrë të pabarabartë dhe në mënyra të ndryshme dhe masat për zgjidhjen dhe tejkalimin e krizës duhen të marrin parasysh perspektivën gjinore dhe multi-dimensionalitetin gjinor të krizës.

Pabarazitë dhe mungesa e mundësive dhe qasjeve ndaj sistemeve, burimeve financiare, informacionit, njohurive, stereotipeve gjinore në shoqëri, shtëpi, në vijën e parë të shërbimit shëndetësor dhe social, dhe në tregun e punës duhet të merren parasysh dhe të adresohen në kompleksitetin e tyre për të adresuar suksesshëm krizën, për të minimizuar efektet e saj, dhe maksimizuar investimet përmes masave të Planit për Zbatimin e Programit për Rimëkëmbjen Ekonomike. Njëkohësisht duhet nënvizuar se përfaqimi dhe zbatimi i një perspektive gjinore gjatë zbatimit të programit të Rimëkëmbjes Ekonomike merr në konsideratë rolin kritik që gratë luajnë në zgjidhjen e krizave në tërësi dhe si faktor i stabilitetit shoqëror. Gratë janë ato që mbajnë më së shumti barrën dhe përgjegjësitë shoqërore, në shtëpi, në shërbim shëndetësor dhe shoqëror, në edukim, në përkujdesin për të moshuarit dhe me aftësi të kufizuara. Në shumë raste, pjesën më të madhe të këtyre përgjegjësive në formë të papaguar ose dhe kur paguhen ato janë në profesione të cilat paguhen më pak se në profesionet e dominuara nga burrat.

Në vijim, gratë janë të punësuarat dhe zotëruese të ndërmarrjeve që i takojnë kategorisë së biznesit të vogël dhe të mesëm, kryesisht të shërbimeve ose në prodhimin e mallrave dhe prodhimeve të cilat gjenden në hallkat e brishta të vargut zinxhiror të furnizimit me mallra dhe produkte për të cilat jo vetëm punojnë shpeshherë në kushte të papranueshme, paguhen minimalisht dhe jo rrallëherë në informalitet por njëkohësisht i shesin prodhimet dhe shërbimet e tyre me çmime jo të favorshme dhe të konkurrueshme. Gratë në të gjitha bizneset e vogla, përballen vazhdimisht me qasjen në teknologji të avancuara për prodhim, marketing, komunikim dhe menaxhim të informacionit, edukimit bazik financiar dhe menaxherial, burimeve bazike financiare me masa interesi të ulëta apo huave pa interes, gjetjes së partnerëve dhe investitorëve, regjistrimit të patentave dhe prodhimeve etj. Kriza ekonomike e shkaktuar nga COVID-19 këto mangësi dhe disavantazhe po i shumëfishon me ritme të larta, çka ka sjelle dhe do të sjellë rritjen e papunësisë në mesin e grave dhe mbylljen dhe falimentimin e ndërmarrjeve të grave në se nuk ndërhyhet me masa të targetuara, të përshpejtuara dhe shumëanëshe.

II. Metodologjia

Në hartimin e këtij dokumenti planifikues, ABGJ ka synuar ta kthejë në një platformë unifikuese dhe të harmonizuar të një serie politikash publike, qëllimet e të cilave mbeten ekzistenciale për zhvillimin dhe luftimin e varfërisë në Kosovë, burojnë nga marrëveshjet dhe platformat e bashkëpunimit dhe zhvillimit me partnerët ndërkombëtarë të Kosovës, në përmbushje të synimeve dhe interesave të vendit si partner i besueshëm dhe kontribuues i zhvillimit dhe paqes. Dokumenti reflekton në frymë dhe në konceptim zbatimin e *Programit të Qeverisë për Kosovën 2020-2023* përkritazi me synimet për promovimin barazisë sociale, fuqizimit socio-ekonomik të grave, zhvillimit të qëndrueshëm gjithëpërfshirës, punësimit të të rinjve dhe grave, edukimit parashkollor dhe edukimit cilësor gjithëpërfshirës të djemve dhe vajzave. Njëkohësisht, dokumenti propozimi është në zbatim të

drejtpërdrejtë me synimet e rritjes gjithëpërfshirëse dhe edukimit parashkollor të nënvizuara në *Strategjinë Zhvillimore të Kosovës*. Në vijim, është në përputhje me një seri aktivitete të shprehura në *Programin e Kosovës për Barazi Gjinore*, zbatimi i të cilave kthehet në prioritet përkitazi me situatën e krijuar nga COVID dhe në përputhje të plotë me vizionin e qeverisë së Kosovës të cituar më sipër. ABGJ ka bashkëbiseduar dhe me grupe të interesit si: shoqata, biznese, Odën Ekonomike, etj. Gjithashtu, ABGJ ka intensifikuar praktikën e ndarjes së informacionit me partnerët ndërkombëtarë për të evituar duplikimin dhe përmirësuar koordinimin dhe rritur eficiencën e masave për luftimin e krizës nga qeveria dhe masave të ndërmarra nga donatorët.

III. Target grupet dhe ndarja e fondeve

Grupet që do të targetohen përmes Masës 10 përfshijnë: a) institucionet e arsimit parashkollor privat dhe ato të regjistruara si OJQ, b) bizneset e vogla private të grave dhe ato që janë të organizuara në kooperativa dhe në zinxhirin e prodhimit dhe furnizimit me lëndë të parë, c) OJQ-të, të cilat ofrojnë shërbime në komunitet, dhe d) biznese që punësojnë gra (këto të fundit vetëm nëse fondi i Masës 10-tw rezulton me tepriçë fondesh pas mbulimit të nevojave të tri grupeve të para).

ABGJ planifikon të zotojë **EURO 1.2 milionë** për institucionet e arsimit parashkollor dhe **EURO 0.8 milionë** për grupet e identifikuara më lart. Shumat e planifikuara mund të rishihen në bazë të volumit të burimeve të kërkuara, vetëm pasi të jenë përmbushur nevojat e institucioneve parashkollore.

IV. Qasja strategjike në zbatim

Me synim maksimalizimin e efekteve investuese, ABGJ në shpërndarjen e fondeve do të kombinojë investimet e target grupeve për qasje komplekse të rrumbullakuar dhe për të plotësuar shërbime të cilat grupet që do të mbështeten kanë nevojë si pasojë e COVID-it. Kështu p.sh. përpos mbështetjes së drejtpërdrejtë që do t'u jepet institucioneve private dhe OJQ-ve të arsimit parashkollor për të adresuar problemet e shkaktuara nga COVID, do të synohet që edukatorëve, prindërve dhe fëmijëve t'u ofrohen shërbime psikologjike të cilat janë identifikuar si të domosdoshme, apo përmirësimin e shërbimeve teknologjike. Po kështu edhe në bizneset që zotërohen nga gratë përpos përfitimit nga burimet që do ju ndahen përmes fondeve të parapara në Masën 10, do të përfitojnë edhe nga shërbime që do t'u ofrohet përmes bizneseve të tjera siç është përmirësimi i metodave të marketingut, krijimi dhe përmirësimi i webfaqeve dhe media sociale, asistencës për regjistrim dhe çertifikim të produkteve dhe patentave, zgjerimit të tregut përmes B2B (business-to-business), etj. Sikurse u vu në dukje dhe më sipër, Masa 10-të do të zbatohet edhe duke u kombinuar me aktivitete dhe masa prioritare nga politikat publike zhvillimore aktuale, për të maksimizuar investimin, rritjen e eficiencës dhe efektivitetit të investimeve të kombinuara dhe përmbushjen e detyrimeve strategjike. (Aktivitetet dhe masat e identifikuara si prioritare nga politikat zhvillimore ekzistuese janë të përfshira në Annex seksionin e këtij dokumenti).

V. Përfituesit nga zbatimi i Masës 10-të

Nga zbatimi i Masës 10-të do të përfitojnë grupet e mëposhtme:

Në formë të drejtpërdrejtë:

- **Institucionet e arsimit parashkollorë privatë dhe të regjistruara si OJQ** – Mbështetja e tyre do të sigurojë vazhdimësinë e biznesit, do të sigurojë punësimin e punonjësve në këto qendra dhe do të kontribuojë në zbutjen e papunësisë dhe zbutjen e efekteve të krizës.

- **Bizneset e grave** – Bizneset e madhësive: familjare, të vogla dhe të mesme ku pronare janë gra dhe punësojnë më së shumti gra do të jenë grupi tjetër i përfituesve të drejtpërdrejtë.
- **OJQ-të e grave dhe OJQ-të që ofrojnë shërbime** – Përmes ofrimit të granteve ndaj këtyre OJQ-ve do të sigurohet dhe vazhdimësia e ekzistencës së tyre dhe shërbimeve që ato ofrojnë të cilat ose nuk ofrohen nga shteti ose ofrohen me kosto të lartë nga sektori privat. Në të njëjtën kohë, mbështetja financiare e OJQ-eve kundrejt përftimit të shërbimeve do të kontribuojë në zbutjen e papunësisë në mesin e grave duke qenë se në këtë sektor punësohen kryesisht gra.

Në formë jo të drejtpërdrejtë:

- **Fëmijët e moshës parashkollore**, një grup ndaj të cilit Kosova edhe me shërbimet që ofron si përmes sektorit publik, ashtu dhe atij privat dhe jofitimprurës mbetet aktualisht deficitar. Mosndjekja e arsimit parashkollor gjatë një moshe ku fitohen 60% e aftësive kognitive që shoqërojnë individin gjatë gjithë jetës, afekton mbarëvajtjen e tij në të gjithë jetëgjatësinë e tij.
- **Prindërit dhe kryesisht nënat me fëmijë të moshës parashkollore**, të cilat nga mospasja e shërbimeve të arsimit parashkollor rrezikojnë të humbasin vendin e punës që do të çojë në rritjen e papunësisë në përgjithësi dhe në uljen e pjesëmarrjes në mesin e grave, çka aktualisht është një problem madhor në Kosovë. Në vijim, pasja e shërbimit parashkollor do të lehtësojë nënat dhe familjet në përgjithësi nga kujdesi për disa orë dhe do të kontribuojë në uljen e efekteve psiko-emocionale të krizës.
- **Familjet e të punësuarve** do të përfitojnë nga burimet financiare të vëna në dispozicion duke zbutur efektet e krizës dhe duke mbajtur stabil të hyrat familjare apo duke kontribuar në moshumbjen e tyre totale apo drastike.
- Do të sigurojë **hyrjen në treg të produkteve** me çmime drejtësisht të konkurrueshme dhe më shumë zgjedhje, si dhe krijimin e produkteve dhe shërbimeve të reja.
- Injektimi i parave në biznese dhe familje **do t'i kontribuojë fuqisë blerëse në treg dhe stabilitetit ekonomik-social dhe zbusë hendekun e varfërisë.**

VI. Modalitetet e zbatimit të Masës 10-të

Në zbatimin e e Masës 10-të, ABGJ do të menaxhojë fondet në bazë të kornizave ligjore të Kosovës për menaxhimin e financave publike dhe do të modifikojë sipas nevojave, gjithmonë në përputhje me kornizat ligjore, format e aplikimit për secilin target grup në mënyrë që të sigurojë monitorim dhe zbatim efektiv dhe pa humbje të burimeve të vëna në shfrytëzim. ABGJ do të krijojë **Komisionin për Përzgjedhje dhe Mbikëqyrje të Zbatimit të Masës 10-të**, me përbërje nga personeli i ABGJ-së, përfaqësues nga shoqëria civile (OJQ me fokus në transparencë e qeverisjes së mire, “think tank” e Oda Ekonomike, etj.)

ABGJ do të sigurojë krijimin e sistemit të monitorimit që në fillim të zbatimit të Masës 10-të. Për secilin target grup që do të financohet nga Masa 10-të do të krijohet sistem të targetuar monitorimi me synim rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes, eficiencës së përdorimit të burimeve njerëzore për monitorim dhe mbajtjes së ulët të kostos financiare administrative të monitorimit. Gjithashtu, do të sigurojë zhvillimin e kriterëve për kualifikim për aplikuesit dhe identifikimin fushave për mbështetje që konsiderohen si prioritare sipas natyrës dhe grupeve të bizneseve (Shih Annex). Grupi i parë me të cilën ABGJ do të fillojë ndarjen e fondit do të jenë institucionet e arsimit parashkollor dhe do të procedojë në vazhdim me të grupet e tjera.

ANNEXES

ANNEX 1. Nismat e propozuara dhe harmonizimi me kornizat e politikave publike

Nismat e Propozuara	Programi i Qeverisë	Strategjia Zhvillimore e Kosovës	Programi i Kosovës për Barazi Gjinore	Qëllimet për Zhvillim të Qëndrueshëm SDG	Detyrimet ndaj BE-së
Edukimi parashkollor	<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i barazisë shoqërore • Edukimi parashkollor • Gjithëpërfshirja dhe barazi në arsim • Fuqizimi i pozitës së femrave në shoqëri 	Gjithëpërfshirja e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe parafillor	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e numrit të arsimit parashkollor dhe parafillor • Subvencionimi i fëmijëve nga prindër vetëushqyes dhe përfitues të skemave sociale dhe të ardhura të ulëta 	Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxëniet gjatë gjithë jetës për të gjithë	Traktati i Lisbonës, Procesi i Kopenhagenit
Bizneset e grave	<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i barazisë shoqërore • Fuqizimi i pozitës së femrave në shoqëri • Zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm 	<ul style="list-style-type: none"> • Lehtësimi i qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare. • Mbështetja në lidhjet ndërmjet ndërmarrjeve në grupime industriale të përafërta. • Përmirësimi i standardeve të cilësisë dhe kalimi në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar. 	<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi dhe zhvillimi i bizneseve në pronësi të grave përmes kredive dhe granteve • Krijimi i strukturave stimuluese • Rritja e ndërmarrësisë dhe punësimit në mesin e grave 	<ul style="list-style-type: none"> • Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj • Të arrihet barazia gjinore dhe të fuqizohen të gjitha gratë dhe vajzat • Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe 	Traktati i Lisbonës Karta Evropiane e të Drejtave të Njeriut

				punë të denjë për të gjithë	
OJQ-të që ofrojnë shërbime	<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i barazisë shoqërore • Fuqizimi i pozitës së femrave në shoqëri • Zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm 	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetja në lidhjet ndërmjet ndërmarrjeve në grupime industriale të përafërta. • Përmirësimi i standardeve të cilësisë dhe kalimi në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar. 	<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i edukimit financiar • Ofrimi i shërbimeve ndaj shtresave në nevojë • Riformatizimi dhe zhvillimi i shprehive dhe shkathtësive sipas nevojave të tregut të punës 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimi një infrastrukture të fortë, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës e të qëndrueshëm dhe nxitja e novacionit • Bëni qytetet dhe vendbanimet njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, elastike (fleksibël) dhe të qëndrueshme 	Karta Evropiane e të Drejtave të Njeriut
Bizneset që punësojnë gra	<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i barazisë shoqërore • Fuqizimi i pozitës së femrave në shoqëri • Zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm 	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetja në lidhjet ndërmjet ndërmarrjeve në grupime industriale të përafërta. • Përmirësimi i standardeve të cilësisë dhe kalimi në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar. 	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës 	<ul style="list-style-type: none"> • Fund urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi të të ushqyerit si dhe promovimi i bujqësisë së qëndrueshme • Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe 	Karta Evropiane e të Drejtave të Njeriut

				<p>punë të denjë për të gjithë</p> <ul style="list-style-type: none">• Të arrihet barazia gjinore dhe të fuqizohen të gjitha gratë dhe vajzat• Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj	
--	--	--	--	---	--

ANNEX 2.

FUSHAT E MBULUARA NGA FONDET E NDARA PËR MASËN 10-TË PËR APLIKUESIT E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT PARASHKOLLOR

- Qira (jo retroaktivisht, vetëm nga data e aplikimit dhe për periudhën për cilën kërkohet mbulesë)
- Pagesë për stafin ekzistues
- Shërbime të ngrohjes (pellet, dru zjarri, gaz, etj.)
- Materiale mësimore dhe mjete didaktike
- Pasurimi i fondit të bibliotekës
- Lodra
- Materiale sanitare dhe higjienike
- Materiale për ndihmën e shpejtë
- Materiale për mbrojtjen nga zjarri
- Përmirësimi apo zgjerimi i infrastrukturës shërbyese (kuzhina, banjo, lavanderi, kënd lojërash në natyrë, lyerje mjedisesh, etj.)
- Pako ushqimore
- Përmirësimi i teknologjisë (vendosja e sistemit të kamerave dhe qasja në system, ndërtimi i webfaqeve dhe mirëmbajtja, etj)
- Materiale fjetjeje dhe përtërimi i tyre
- Programe udhëzuese për prindër dhe fëmijë
- Subvencionim i pagesave të shtresave në nevojë me përparësi nënat dhe prindër vetëushqyes, skemat sociale dhe komunitete
- Pagesë të shpenzimeve transportuese kur institucioni siguron transportin për fëmijët në baza ditore.

Shënim. Fushat e lartpërmendura janë të identifikuar për arsye orientuese dhe nuk nënkuptojnë nevojshmerisht mbulesë për gjithësecilën prej tyre. ABGj ruan të drejtën e shpërndarjes së fondeve në bazë të nevojave dhe barazpeshimit të vlerave totale në shpërndarje.

ANNEX 3

KRITERET E FINANCIMIT

Për kualifikim dhe përfitim nga fondet e Masës 10-të, aplikuesit e institucioneve parashkollore duhet të paraqesin dokumentet dhe përmbushin detyrimet e listuara më poshtë:

- ✓ Të jenë të regjistruara dhe licencuara dhe të provojnë licencimin përmes dorëzimit të kopjes së dokumentit nga MASHT ose Departamenti për Regjistrimin e OJQ-ve
- ✓ Të dorëzojnë dëshmi të pagesës së taksave për vitin 2018 ose 2019-të,
- ✓ Të dorëzojnë listën e punonjësve për periudhën tetor 2019- mars 2020, për të cilët kanë derdhur detyrimet pensionale,
- ✓ Kopje të kontratës e qiramarrjes të noterizuar (kopje) – (Vetëm për rastet kur mjedisi ku ushtrohet aktiviteti është i marrë me qira),
- ✓ Kopje të dëshmisë së tatimit në pronë nga qiradhënësi,
- ✓ Vërtetim nga institucioni publik kur aktiviteti ushtrohet në mjedis të pronës publike.

Në aprovimin e fondit, aplikuesi duhet të bjerë paraprakisht përpos detyrimeve që burojnë nga kornizat ligjore të Kosovës, duhet të bjerë dakord për plotësimin e kushteve të mëposhtme:

- Të gjithë të punësuarve t'u paguhen detyrimet pensionale,
- Ndaljen e pagesës kur fëmijët mungojnë dhe nuk paraqiten pranë institucionit,
- Plotësimi i regjistrit së paraqitjes së fëmijëve në baza ditore dhe shënimi i justifikimit të prezantuar nga prindërit apo kujdestari i fëmijës për mosparaqitjen e fëmijës,
- Pranimin e një numri të kufizuar të fëmijëve nga familje me prindër vetëushqyes, nën nivelin varfërisë dhe shtresave në nevojë kur ekzistojnë vende vakante dhe nuk bien ndesh me kriteret dhe kërkesat e mbrojtjes nga COVID-19 në përputhje me masat e lëshuara nga MSH dhe MASHT.